

Deklaratë e misionit të FMN-së në Përfundim e një Misioni Konsultimi Nenit IV për Republikën e Kosovës dhe Diskutime mbi Programin për Monitorim të Stafit

**Njoftim për shtyp Nr 11/208
1 Qershor 2011**

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të udhëhequr nga Z. Johannes Wiegand, ka realizuar bisedime me autoritetet kosovare gjatë datave 17-30 Maj, 2011. Misioni kreu bisedime rreth Nenit IV të Konsultimeve për vitin 2011 dhe u dakordua me autoritetet për një Program mbi Monitorimin e Stafit (PMS) deri në fund të 2011.¹

Në përfundim të vizitës, Z. Wiegand dha deklaratën e mëposhtme:

"Kosova përjetoi një rritje të fuqishme në vitet 2000 dhe e ka përballuar mirë krizën ekonomike globale. Megjithatë, ekonomia varet nga transfertat dhe investimet direkte të diasporës kosovare, një model rritje që gjasat më të mëdha i ka të jetë i paqëndrueshëm. Për më tepër, sfidat sociale janë të thella, me të papunësinë që vlerësohet të jetë rreth 40 për qind e fuqisë punëtore. Rritja e konkurrencës - përmes reformave administrative dhe ligjore, infrastrukturë më të mirë, dhe përmbajtje të pagave - janë të nevojshme për të nxitur lindjen e një sektori të tregtueshëm dhe rritjen e vetë-qëndrueshme.

Politika fiskale adreson nxitjen për rritje të kapitalit dhe shpenzimit social nga një bazë e kufizuar të ardhurash. Për periudhën afat shkurtër është i rëndësishëm zbatimi i buxhetit të disiplinuar. Për periudhën afat mesme nevojitet një ri-orientimi i prioritetëve fiskale, duke përfshirë edhe rritjen e të ardhurave nga taksat e drejtpërdrejta. Sistemi financiar është zhvilluar me hapa të shpejtë, duke ruajtur një strukturë të shëndoshë të financimit."

"Misioni ka arritur një marrëveshje në nivel të stafit me autoritetet mbi një paketë politikash që do të monitorohen në kuadër të Programi për Mbikëqyrjen e Stafit deri në fund të 2011. Politikat përcaktojnë hapa vendimtarë drejt qëndrueshmërisë fiskale dhe menaxhimit dhe ekzekutimit më të mirë të buxhetit. Implementimi i suksesshëm do të ndihmojë në krijimin e hapave drejt menaxhimit të shëndoshë fiskal, gjë që do të hapë rrugën për një rishikim të ndihmës financiare nga FMN për vitin 2012 dhe për të lehtësuar vazhdimësinë e mbështetjes së donatorëve. "

¹ PMS është një marrëveshje joformale me stafin e FMN-së për të monitoruar zbatimin e programit ekonomike të autoriteteve. Kjo nuk kërkon miratim nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së dhe as ndihmë financiare nga FMN-ja.

DEPARTAMENTI PËR MARDHËNIE ME JASHTË I FMN

Marrëdhënie me Publikun

E-mail: publicaffairs@imf.org

Fax: 202-623-6278

Marrëdhënie me Mediat

Tel: 202-623-7100

Fax: 202-623-6772

